



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.173/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me sekretaren juridike Raxhije Emmini, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson Atila Elshani nga Prizreni, kundër të paditurit F. Q. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. P.P. nga Prizreni, me objekt të padisë pagimin e qirasë, vlera e kontestit 468.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën **17.07.2014**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Komuna e Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri F. Q. nga Prizreni, t'ia paguajë borxhin në emër të qirasë në shumën prej 468.00 €, me kamatë ligjore e cila të llogaritet nga data 04.02.2012 e deri në ditën e pagesës definitive dhe atë në llogarinë rrjedhëse të paditësit në bankat e licencuara në Kosovë, në afatë prej 7 ditësh pas pranimit të aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Obligohet paditësja Komuna e Prizrenit që në emër të shpenzimeve procedurale të paditurit F. Q. ti paguajë shumën prej 239 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore është zhvilluar sipas rregullave të parapara me LPK-në, e që i referohen kontesteve me vlerë të vogël.

E autorizuar e paditëses Atila Elshani në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe kërkesëpadi, duke i propozuar gjykatës që të administroj provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe pas administrimit të tyre të njëjtën ta aprovon në tërësi si të bazuar. Gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurin që të paguaj shumën e kërkuar si në padi me kamatë ligjore, nga data e parashtrimit të kësaj padie. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurit av. P. P. në shqyrtimin kryesor deklaroi se mbetet në tërësi pranë të cekurave në përgjegje në padi (prapësim), përmes të cilave e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tutje ka shtuar se i padituri me pëlqimin e paditëses ka bërë investime në lokalit afarist, e cila shumë e kap vlerën e qirasë për periudhën kontestuese. Duke marr parasysh që detyrimi është krijuar në vitin 2007, ndërsa padia është parashtruar në vitin 2012, atëherë i propozon gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit ashtu siç parashihet me dispozitat e LMD-së. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për një përfaqësim dhe për përpilimin e prapësimin në shumë të përgjithshme prej 315 €.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën mbi dhënien me qira të lokalit afarist me nr. ../-...-../.., datë 29.01.2007, vërejtjen para padisë me nr, ../..-zyrtar, datë 25.01.2012, shënimin zyrtar të lëshuar nga SH.H “.... ..” datë 26.08.2010.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **e pabazuar**, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit.

Nga provat e administruara gjykatës i rezultoi se Komuna e Prizrenit-paditësja me të paditurin F. Q. , ka lidhur kontratën mbi dhënien me qira të lokalit afarist me nr. ../-...-../.. , datë 29.01.2007, me kohëzgjatje nga data 01.01.2007 deri me datë 31.12.2007. Nëse i referohem përmbajtjes së padisë atëherë rezulton se paditësja kërkon nga i padituri që ti paguhen shumat e qirasë dhe atë prej datës 07.05.2007, e deri me datë 31.12.2007. Në bazë të kontratës së cekur më lartë i padituri ka pasur për obligim që qiranë ta paguajë në çdo fillim muaji, më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Paditësja padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 22.02.2012, që do të thotë pas kalimit të afatit ligjor, të paraparë me nenin 375, i cili përcakton se *”Kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shumë totale, parashkruhen për 3 vite”*. Nga kjo rezulton se pretendimi i palës së paditur se kërkesa e palës paditëse është parashkruar është plotësisht e bazuar, pasi që kjo e fundit padinë e ka parashtruar pas kalimit të afatit ligjor 3 vjeçar (neni 375 i LMD-së). Në anën tjetër pala paditëse nuk i ofroi gjykatës ndonjë provë materiale e cila do të dëshmonte faktin se paditësja ka ndërmarr ndonjë veprim paraprak, i cili do të qonte eventualisht në ndërprerjen e afatit të parashkrimit, ashtu siç parashihet me dispozitat e LMD-së. Veprimin e parë të cilin e ka ndërmarrë pala paditëse ka qenë vërejtja para padisë me nr, ../..-zyrtar, datë 25.01.2012.

Nga të cekurat më lartë, gjykata nuk i vlerësoi provat e parashtruara nga pala paditëse, të cilat kanë të bëjnë me bazueshmërinë apo jo të kërkesëpadisë së saj.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi konform nenit 451.1 të LPK-së dhe TA-së, ku e obligoi palën paditëse që t’ia kompensojë

shpenzimet e procedurës palës së paditur në shumë prej 239 € dhe atë 135 € për përfaqësim në një seancë të mbajtur dhe 104 € për përpilimin e prapësimin kundër aktvendimit për lëshimin e urdhërpagesës. Gjykata e refuzoi pjesën e kërkesës së palës së paditur për kompensimin e shpenzimeve procedurale mbi shumën e aprovuar, pasi konsideroi se shuma prej 239 € është në përputhje të plotë me TA-në.

Nga të lartcekurat dhe bazuar nenin 375 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.173/12, datë 17.07.2014

**Sekretare juridike,
Raxhije Emini**

**Gjyqtari,
Lumni Sallauka**

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate. Konform nenit 491 parag.1 të LPK-së, aktgjykimi mund të goditet vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave mbi procedure kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale..